



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 558/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, kundër Komisionarëve të Qendrës së Votimit për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR)

ARSYETIM

Subjekti Politik AKR dega në Prishtinë ka parashtruar ankesë kundër kryesuesit të QV, duke pretenduar se më datë 12.12.2010 në QV 1227e/01 dhe 05 në shkollën fillore “Shkendija” në Hajvali, komisionarët dhe vëzhguesit kanë keqpërdorur votën gjatë numërimit.

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga LVV, duke pretenduar se kryesuesi i VV 1909e/09D ka shkaktuar parregullsi gjatë procesit të votimit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e subjektit politik AKR, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

. PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

A nr. 558/2010 më datën 16.12.2010.

